

KONTRATË DHURIMI

(Kuotash të Shoqërisë)

Në Tiranë, sot më datë 17.03. 2023, në zyrën e shoqërisë "Bigalb Group" sh.p.k, duke u bazuar në legjislacionin shqiptar, në veçanti në ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare", i ndryshuar dhe në ligjin Nr.9723 date 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit" i ndryshuar, lidhet kjo kontratë huaje midis palëve të mëposhtme:

PALA E PARË: Znj. Natasha Hodaj, e bija e Metes, e datëlindjes 02.02.1954 e lindur në Brataj, Vlorë dhe banuese në Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me nr. karte ID 035893546 dhe nr personal F45202165K, që këtu e në vijim "**Dhuruesi**"

PALA E DYTË: Znj. Monika Çela, e bija e Metes, e datëlindjes 14.07.1965 e lindur në Brataj, Vlorë dhe banuese në Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me nr. karte ID 032287801 dhe nr personal G55714058E, që këtu e në vijim. "**Përfituesi**"

HYRJE

A. Shoqërisa "BIG UNIONI" shpk, është person juridik i regjistruar në regjistrin tregtar pranë QKB më datë 22.01.2015, pajisur me nipt L61501009T, me seli në adresën Tirane Kamez KAMEZ Lagjja 6, Zona Kadastrale 3992, Nr.Pasurie 1/18, Bathore, me ortakë:

- | | |
|--|---|
| 2.1.1 Shoqëria "BIGALB GROUP" SHPK: | Numri i Pjesëve 1 (një);
Pjesëmarrja në përqindje 51%; |
| 2.2.1 Znj. Natasha Hodaj: | Numri i Pjesëve 1 (një);
Pjesëmarrja në përqindje 49% |

B. Palët kanë rënë dakort që kuotat e zotëruara nga Dhuruesi, të kalojnë tek Përfituesi mbas firmosjes së kësaj kontrate.

C. Shoqëria "BIG UNIONI" shpk, Shoqëria "Bigalb Group" Sh.p.k, përfaqësuar nga Znj. Elona Koshi, me cilesinë e "Personit të Besuar" Z. Vullnet Sinaj, me vendimin Nr. 01 të datës 17.03.2023, në mënyrë të shprehur kanë dhënë aprovimin e tyre për këtë dhurim.

Duke vlerësuar bashkëpunimin dhe interesin e ndërsjellë, palët bien dakort për redaktimin e kësaj Kontrate Dhurimi si më poshtë:

Neni 1

Baza Ligjore

1.1 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, më posaçërisht Nenet 659 e vijues të tij;

1.2 Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", më posaçërisht nenet 72-75 të tij.

Neni 2
Objekti

- 2.1 Dhuruesi do t'i kalojë Përfituesit, kuotën e saj, në masën e 49% (dyzetë e nëntë për qind) të kapitalit, që Dhuruesi zotëron në shoqërinë Big Unioni.
- 2.2 Mbas dhurimit të kuotave, Shoqëria "BIG UNIONI" shpk, do të zotërohet nga ortakët si më poshtë:

1. Shoqëria "BIGALB GROUP": Numri i Pjesëve 1 (një);
Pjesëmarrja në përqindje 51% (pesëdhjetë e një për qind);
2. Znj. Monika Çela: Numri i Pjesëve 1 (një);
Pjesëmarrja në përqindje 49% (dyzetë e nëntë për qind);

Neni 3
Afati

- 3.1 Afati i kalimit të këtyre kuotave do të jetë një 1 (një) muaj nga nënshkrimi i kësaj kontrate.

Neni 4
Vlera e dhurimit

- 4.1 Kuota me pjesëmarrjen në përqindje 49% (dyzetë e nëntë për qind), që do të dhurohet, ka vlerën 980.000,00 Lekë.

Neni 5
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 5.1 Palët bien dakort që çdo mosmarrëveshje që mund të lindë në lidhje me kuptimin dhe realizimin e kësaj kontrate, do ta zgjidhin me mirëkuptim.
- 5.2 Në rast se mosmarrëveshjet e mundshme nuk zgjidhen me mirëkuptim, secila nga palët mund t'i drejtohet për shqyrtim Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- 5.3 Legjislacioni i zbatueshëm do të jetë legjislacioni shqiptar.


Neni 6
Të tjera

- 6.1 Kontrata lexohet nga ne palët dhe pasi gjendet konform ligjit dhe vullnetit tonë të lirë, e nënshkruajmë atë rregullisht.
- 6.2 Kontrata redaktohet në 2 kopje, me fuqi të njëjtë.
- 6.3 Bashkangjitur dokumentat:
1. Ekstrakt i Regjistrimit Tregtar të Shoqërisë "BIG UNIONI" shpk;
 2. Vendim Nr. 01, datë 17.03.2023 i Shoqërisë "BIG UNIONI" shpk;
 3. Dokumentat ID të palëve.

PALËT:

DHURUESI

Znj. Natasha Hodaj



PËRFITUESI

Znj. Monika Çela

